



~~Формирано здружение ВМРО-ДПМНЕ во Албанија~~



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM
TIRANË

Nr. 1438/280 Regj. Themeltar
Datë regjistrimi 16.12.2024

Nr. 7607 Vendimi
Datë 22.07.2025

VENDIM

“Për regjistrimin si person juridik, organizatë jofitimprurëse”

GJYQTAR:
INA HOXHAJ

sot më datë 22.07.2025, mori në shqyrtim në dhomë këshillimi pa praninë e palëve, kërkesën me nr.1438/280 Regjistri Themeltar, që i përket:

KËRKUES: Alban Duraj, i datëlindjes 20.06.1987, lindur në Berat dhe banues në Tiranë, me numër personal identifikimi: I706200720, me numër licence 5860, anëtar i Dhomës së Avokatisë Tiranë, me autorizim sipas aktit noterial nr. Rep. 3782, datë 13.12.2024, të anëtarëve themelues të shoqatës “VMRO-DPMNE, Shqipëri”.

OBJEKTI: Regjistrimin si Person Juridik, i Shoqatës “VMRO-DPMNE, Shqipëri”.

BAZA LIGJORE: Ligji nr. 8788, datë 07.05.2001 “Për organizatat jofitimprurëse”, i ndryshuar; si dhe ligji nr. 80/2021 “Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse”, i ndryshuar.

Gjykata pasi shqyrtoi në tërësi, aktet shkresore bashkangjitur kërkesës objekt gjykimi,

VEREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi, z. Alban Duraj, në cilësinë e përfaqësuesit me autorizim të anëtarëve themelues, ka paraqitur përpara Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, kërkesën për regjistrimin e organizatës jofitimprurëse, në formën e shoqatës, me emërtimin “VMRO-DPMNE, Shqipëri”. Kërkuesi ka bashkëlidhur kërkesës aktin e themelimit dhe statutin e shoqatës.

2. Nga aktet bashkëlidhur kërkesës, rezulton se, themeluesit, znj. Elena Simonofski, z. Mikel Uruçi, z. Kristo Cfetko, znj. Elena Gorica, znj. Qirjako Gorica, znj. Dhimitra Vurmo kanë shprehur vullnetin, për themelimin e shoqatës të lartpërmendur, si një organizatë jofitimprurëse, pa qëllime fitimi, dhe e pavarur. Kohëzgjatja e shoqatës është pa afat.

3. Qëllimi i shoqatës është përcaktuar në nenin 3 të aktit të themelimit dhe të statutit, nën titullin "Qëllimet dhe objektivat e veprimtarisë" ku thuhet se:
- "Qëllimi dhe objektivi i veprimtarisë së shoqatës do të jetë:
- Zhvillimi kulturor, arsimor dhe i informacionit, me qëllim të ruajtjes së identitetit kombëtar të pakicës maqedonase në Shqipëri;
 - Pjesëmarrja aktive në mbrojtjen e të drejtave universale të njeriut, familjeve tradicionale dhe të pakicave;
 - Formimi i platformave mediatike për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të pakicave;
 - Mbrojtja e trashëgimisë natyrore, kulturore dhe etnike të pakicës maqedonase dhe prezantimin e vlerave turistike, për të promovuar komunitetin tonë në Shqipëri dhe jashtë vendit;
 - Ruajtja e monumenteve kulturore dhe fetare, si dhe marrja e iniciativave për të ndërtuar monumente të reja ose për t'i restauruar;
 - Vendosje e bashkëpunimit me shoqata të tjera të cilat mbrojnë dhe mbështesin të njëjtat vlera;
 - Përfshirje dhe angazhim i rinisë dhe qytetarëve në projekte të shoqatës;
 - Mbështetje ndaj qytetarëve për të përparuar në drejtim të respektimit të të drejtave të njeriut dhe pakicave, si dhe të marrin pjesë në zgjidhjen dhe krijimin e kushteve më të mira të jetesës;
 - Angazhim në ndërmjetësim për përmirësimin e shëndetit fizik dhe mendor të njerëzve;
 - Intensifikimi i aftësive sociale për rehabilitimin profesional dhe zhvillimin e karrierës nëpërmjet zhvillimit profesional;
 - Angazhim në përmirësimin e kushteve të tregut të punës;
 - Krijimi i aktiviteteve edukative për qytetarët;
 - Organizimi i aktiviteteve vullnetare;
 - Përgatitja dhe zbatimi i programeve të qarta vullnetare për zhvillim dhe të dobishme për të gjithë njerëzit;
 - Ndikim dhe marrje pjesë në mënyrë aktive në krijimin, zhvillimin dhe implementimin e eventeve profesionale, kulturore, sportive dhe argëtuese;
 - Përkrahja për prodhimin dhe promovimin e ushqimit të shëndetshëm bio, si dhe ruajtjen e zanateve tradicionale;
 - Pjesëmarrja aktive në projekte në fushën e mjedisit, kulturës dhe mirëmbajtjes ekologjike;
 - Bashkëpunim me të gjitha institucionet shtetërore, si ato arsimore, shëndetësore, etj.;
 - Pjesëmarrje aktive në luftën kundër të gjitha formave të varësisë nga të cilat është e kërcënuar rinia;
 - Bashkëpunim aktiv me të gjitha organizatat kombëtare e ndërkombëtare, joqeveritare, shoqatave civile, organizatave dhe agjencive humanitare;
 - Luftë kundër trafikimit të qenjeve njerëzore dhe të gjitha formave të diskriminimit në shoqëri;
 - Përmirësimi i kushteve të jetesës së fëmijëve të moshës shkollore dhe parashkollore;
 - Zhvillim i shëndetit dhe jetës shpirtërore;
 - Zhvillim dhe ngritje e nivelit kulturor të shoqërisë;
 - Mbështetje për ndërtimin civil dhe demokratik të shoqërisë, zhvillimin dhe zgjerimin e parimeve të shtetit të së drejtës;
 - Ndihmë në zhvillimin e multikulturalizmit në të gjitha aspektet e jetës publike dhe zgjerimin e njohurive rreth tyre;

- Zhvillimin dhe krijimin e lidhjeve të reja dhe partneritete në zbatimin e projekteve të veçanta me ndihmën e institucioneve shtetërore dhe joshetërore.”

4. Sipas aktit të themelimit Shoqata e ka selinë në adresën: Rruga “Ndre Mjeda”, Hyrja nr. 2, Apartamenti nr. 35, Njësia Administrative nr. 7, Zip 1023, Tiranë. Po ashtu, në statut është përcaktuar se Shoqata ka vulën dhe logon e vet, të cilat përdoren në dokumentacionin zyrtar dhe korrespondencën me palë të treta.

5. Në statut është parashikuar se organet drejtuese dhe ekzekutive të Shoqatës janë: 1) Mbledhja e Përgjithshme e Anëtarëve, si organi më i lartë vendimmarrës; 2) Bordi Drejtues; 3) Drejtori Ekzekutiv, si organ përfaqësues i shoqatës dhe drejtues/kryetar i Bordit. Në statut janë përcaktuar edhe kompetencat dhe përgjegjësitë e këtyre organeve. Po ashtu janë përcaktuar edhe rregullat mbi vendimmarrjen si dhe kuorumin e nevojshëm për vlefshmërinë e këtyre vendimeve.

6. Në nenin 7 të statutit është parashikuar ndalimi i çdo lloj shpërndarjeje të fitimit ose përfitimit financiar dhe material ndërmjet anëtarëve ose të tretëve. Fitimi dhe të ardhurat e realizuara nga aktiviteti dhe burimet financiare qendrojnë në fondin e shoqatës për t’u përdorur me qëllim vijimin e aktivitetit të saj.

7. Në nenin 6 të statutit janë përcaktuar edhe burimet e të ardhurave ku thuhet se:

“Shoqata hap llogarinë e vetë në bankë. Të ardhurat do të sigurohen si të vendosen pas mbledhjes së parë të përgjithshme të anëtarëve. Çdo anëtar i shoqatës do të paguajë kuotizacionin e tij çdo gjashtë muaj në shumën që do të caktohet nga Këshilli Drejtues. Gjithashtu, burimi financiar do të jetë nga donatorë të ndryshëm brenda dhe jashtë vendit, nga persona juridikë dhe fizikë, dhurata të ndryshme, sende të luajtshme dhe të paluajtshme, çdo gjë sipas ligjit në fuqi. Buxheti i shoqatës do të konsistojë edhe nga dhuratat dhe ndihmat nga shoqata ndërkombëtare, shoqatat homologe të huaja, shoqata të ndryshme, duke bërë evidentimin e saktë sipas legjislacionit.”

8. Në statut në nenin 17 të tij janë parashikuar edhe rregullat mbi ndryshimin e tij me pjesëmarrjen e të gjithë anëtarëve themelues të shoqatës¹. Po ashtu, në statut janë parashikuar edhe rregullat mbi shpërndarjen e shoqatës, përjashtimin e një anëtari, si dhe për likuidimin e shoqatës.

9. Së fundi, në statut është përcaktuar edhe drejtuesi i parë ekzekutiv dhe përfaqësuesi ligjor i Shoqatës me të tretët, konkretisht znj. Elena Simonofski. Ndërsa anëtarë të Bordit Drejtues janë znj. Elena Simonofski, z. Mikel Uruçi, z. Kristo Cfetko, znj. Elena Gorica, znj. Qirjako Gorica, znj. Dhimitra Vurmo. Sipas statutit, drejtuesi ekzekutiv dhe anëtarët e Këshillit Ekzekutiv kanë mandat 4 vjeçar.

II. Arsyetimi i gjykatës.

10. Gjykata, pasi shqyrtoi kërkesën e paraqitur nga kërkuesi, z. Alban Duraj, në cilësinë e përfaqësuesit me autorizim nga anëtarët themelues të Shoqatës “VMRO-DPMNE, Shqipëri” dhe personit të autorizuar për regjistrimin fillestar të saj, në regjistrin elektronik të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, vlerëson se kjo kërkesë është e bazuar në ligj dhe duhet pranuar.

11. Në nenin 46 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë është parashikuar se: “Kushdo ka të drejtë të organizohet kolektivisht për çfarëdo qëllimi të ligjshëm... Organizatat ose shoqatat që ndjekin qëllime antikushtetuese janë të ndaluara sipas ligjit...”

12. Në nenin 39 e vijues të Kodit Civil dhe në ligjin nr. 8788, datë 7.5.2001 “Për organizatat jofitimprurëse”, është rregulluar e drejta për formimin e shoqatave si një nga llojet e personave

¹ Saktësuar dhe korigjuar me kërkesën e depozituar në sekretari me datë 10.06.2025.

juridikë, midis 5 ose më shumë personave fizikë ose më shumë se dy personave juridikë, që ndjekin një qëllim të ligjshëm, në të mirë dhe në interes të publikut ose të anëtarëve të saj.

13. Sipas nenit 33/3 të ligjit nr. 80/2021, kërkesa për regjistrim refuzohet vetëm në rastet kur:
“...a) kërkesa nuk është në përputhje me kushtet e përcaktuara në këtë ligj ose në ligjin për organizatat jofitimprurëse dhe kërkuesi nuk plotëson ose ndreq të metat që pengojnë regjistrimin brenda afatit;

b) të dhënat që kërkohen të regjistrohen janë të ndryshme nga të dhënat e regjistruar më parë, sipas dispozitave të këtij ligji ose të ligjit për organizatat jofitimprurëse;

c) individë, pjesë e themeluesve ose organeve drejtuese apo vendimmarrëse të organizatës jofitimprurëse, janë në listën e personave të shpallur sipas legjislacionit në fuqi për masat e sigurimit financiar të terrorizmit.”

14. Gjykata vlerëson se, në rastin konkret, nuk paraqitet asnjë rrethanë penguese në kuptim të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Kodit Civil, ligjit nr. 8788, datë 07.05.2001 “Për organizatat jofitimprurëse” si dhe ligjit nr. 80/2021 “Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse”, sipas të cilës gjykata nuk pranon kërkesën për regjistrim fillestar.

15. Gjykata vlerëson se kërkesës i janë bashkëlidhur edhe dokumentet shoqëruese që provojnë të dhënat që regjistrohen, sipas formës të kërkuar në ligj.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata, bazuar në ligjin nr. 8788, datë 07.05.2001 “Për organizatat jofitimprurëse”, i ndryshuar, ligjin nr. 8789, datë 07.05.2001 “Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse”, i ndryshuar, ligji 80/2021 “Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse”, nenet 306-310 të Kodit të Procedurës Civile:

VENDOSI:

1. Pranimin e kërkesës;
2. Regjistrimin si person juridik, i themeluar në formën e shoqatës, të subjektit “VMRO-DPMNE, Shqipëri”;
3. Shoqata e ka selinë në adresën: Rruga “Ndre Mjeda”, Hyrja nr. 2, Apartamenti nr. 35, Njësia Administrative nr. 7, Zip 1023, Tiranë.
4. Shoqata krijohet me vullnetin e lirë të themeluesve të mëposhtëm, sipas Statutit dhe Aktit të themelimit:
 - znj. Elena Simonofski;
 - z. Mikel Uruçi;
 - z. Kristo Cfetko;
 - znj. Elena Gorica;
 - znj. Qirjako Gorica; si dhe
 - znj. Dhimitra Vurmo.
5. Shoqata “VMRO-DPMNE, Shqipëri” ka për qëllim të veprimtarisë së saj objektin e ligjshëm të përcaktuar sipas Statutit dhe Aktit të themelimit të Shoqatës;
6. Shoqata nuk do të ndjekë qëllime politike apo ekonomike. Ajo është organizatë jofitimprurëse dhe joqeveritare.
7. Kohëzgjatja e Shoqatës është me afat të pakufizuar;

8. Organet drejtuese të Shoqatës janë: 1) Mbledhja e Përgjithshme e Anëtarëve, si organi më i lartë vendimmarrës; 2) Bordi Drejtues; 3) Drejtori Ekzekutiv.
9. Anëtarët e Bordit Drejtues janë: 1) znj. Elena Simonofski (Kryetare/Drejtor Ekzekutiv); 2) z. Mikel Uruçi (Nënkryetar); 3) z. Kristo Cefeko (Sekretar); 4) znj. Elena Gorica (Anëtare); 5) znj. Qirjako Gorica (Anëtare); si dhe 6) znj. Dhimitra Vurmo (Anëtare), të cilët qëndrojnë në detyrë 4 vjet.
10. Drejtori ekzekutiv dhe njëkohësisht përfaqësues ligjor i shoqatës me të tretët, është zgjedhur në mandatin e parë, znj. Elena Simonofski, me mandat 4 vjeçar, me të drejtë rikandidimesh.
11. Të ardhurat e Shoqatës, do të sigurohen nga kontributi i themeluesve si dhe të ardhurat e tjera, sipas Statutit dhe Aktit të themelimit të Shoqatës. Në çdo rast, bazuar në kërkesat për organizatat jofitimprurëse dhe ligjit për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse, do të bëhet evidentimi i këtyre mjeteve financiare dhe do të hartohet dokumentacioni përkatës.
12. Udhërohet depozitimi i akteve themeluese në Regjistrin e Organizatave Jofitimprurëse dhe Zyrën e Regjistrimit që të kryejë veprimet përkatëse sipas ligjit.
13. Shpenzimet gjyqësore në ngarkim të kërkuarit.

U shpall në Tiranë, sot me datë 22.07.2025.

GJYQ TAR
INA HOXHAJ

Shpenzime gjyqësore
Taksë regjistrimi 1000 leke
TOTALI 1000 leke

